Regullim i trupave ujore ose biznes joligjor?

PROF. D-R BILJANA PULESKA JANUSHEVSKA
M-R DEJAN ANDONOV



Rezyme

Nxjerrja e rërës, zhavorit dhe gurit nga shtretërit e rrjedhave ujore, liqeneve dhe akumulacioneve është masë për regullimin dhe mirëmbajtjen e ujërave sipërfaqësore. Në Ligjin për ujëra egziston ndalesë e përgjithshme për nxjerje të rërës, zhavorit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e trupave ujore sipërfaqësore, sepse ky aktivitet shkakton proces të erozionit, e kufizon ose e pamundëson shfrytëzimin e ujërave, e çregullon stabilitetin e bregut, e shkatëron shiritin rreth bregut dhe baraspeshën natyrore të ekosistemeve të bregut të ujërave, me çka degradohet natyra dhe peisazhi dhe mund të vjen deri te derdhja e ujit. Sidoqoftë, me përjashtime, nxjerja është e mundur si masë e regullimit dhe mirëmbajtjes e trupave ujore dhe mbrojtje e rajoneve erozive, në bazë të licencës ose në pajtim me kushtet licencës të dhënë.

Kur nuk janë të siguruara kushtet themelore për regullim dhe mirëmbajtje precize të trupave ujore, krijohet klimë në të cilën motivi i nxjerjes të këtyre lëndëve të para minerale është lukrativ dhe nuk kryhet për realizimin e interesit publik për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm mbi ujërat. Në këtë mënyrë, në vend të regullimit të trupave ujore sipërfaqësore, nxjerja e materijalit bëhet biznes joligjor me qëllime komercijale.

Rekomandime për Qeverinë e RMV

- Të analizohen zgjidhjet ligjore dhe kompetencat të parapara me to(a është adekuate dhe pse regullimi i trupave ujore sipërfaqësore është në kompetencë të subjektit i cili është themeluar si shoqëri tregtare për realizim të qëllimeve lukrative);
- Të përcaktohet kompetencë e vërtetë dhe të largohen përputhjet të kompetencave lidhur me regullimin e ujërave sipërfaqësore;
- Të përcaktohet me ligj cilat subjekte ligjore mund të nxjerin rërë, zhavor dhe gur;
- Të përcaktohen në mënyrë ligjore kushtet, mënyra dhe procedura për lëshimin e shfrytëzimit dhe për shitje të materijalit të nxjerur dhe të vendosen mekanizma kontrollues;
- Të sjellet propozim për inkriminim të praktikave joligjore për nxjerje të rërës,zhavorit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e ujërave sipërfaqësore;
- Të miratohen planet për regullim dhe menaxhim me rrjedhë lumore dhe program për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm mbi ujërat, të mundësohet zbatimi i tyre dhe të vendosen mekanizma kontrolluese.

Rekomandime për MMJPH

- Të miratohen aktet nënligjore për implementim të dispozitave për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm mbi ujërat dhe për regullim të shtratit dhe brigjeve të ujërave sipërfaqësore;
- Të sjellet plan për mbrojtje nga vërshimet për rajonet që nuk janë në kompetencë të komunave dhe subjekteve tjera në pajtim me ligjin dhe të përcaktohen kriteret dhe prioritetet për nxjerje të rërës,zhavorit dhe gurit nga trupat ujore sipërfaqësore;
- Të revidohet procedura, kriteret dhe kushtet për dhënien e licencës për nxjerje të rërës,zhavorit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet nga trupat ujore sipërfaqësore dhe për dhënie të lejes për shfrytëzim të materialit tepricë(të vendoset kusht për dokumentacion të azhuruar teknik, të vendoset kontrollë në lokacione para dhe pas dhënies të licencës);
- Të përmirsohet sistemi për mbledhje dhe transfer i të dhënave dhe informatave lidhur me nxjerjen e rërës,zhavorit dhe gurit;
- Të mundësohet qasje deri te të dhënat nga sistemi dhe të forcohet mbikqyrja inspektuese për shkak të implementimit të detyrimeve të përcaktuara me ligj;
- Të mundësohet qasje deri te të dhënat nga sistemi për publikun;
- Të krijohet sistem për ankesa nga publiku për praktikat joligjore dhe të veprohet në bazë të tyre.

Tema e nxjerjes joligjore të rërës, zhavorit dhe gurit dhe keqpërdorimi i materijalit është aktual një kohë më të gjatë. Në raport për rjedhën e lumit Vardar të Entit shtetëror për revizion tregohet se bëhet shkretimi i shtretërve të lumejve të lumit Vardar dhe degëve të sajanë afërsi të Zhelinës të Tetovës, fshatit Siriçinë, në Cërna Reka(Rosoman, fshatrat Manastirec, Trstenik, Sirkovo), në lumin Bregallnica në Karbinci të Shtipit dhe në lumin Pçinja në Konjare të Epërme. Eksploatimi joligjor i përcjell proceset erodive dhe sjell deri te paraqitja e vërshimeve, me këtë i rrezikon shëndetin dhe pronat e popullatës. Edhe Inspektorati shtetëror për ekonomi të ujërave disa herë deri tani ka konstatuar eksploatim joligjor të rërës, zhavorit dhe gurit, përkundër licencës të dhënë ose jo. Gjithashtu, në disa raste janë konstatuar raste të veprimit koncesionues për eksploatim të lëndëve të para minerale në brigje në kundërshtim me ligjin. Egzistojnë dhe raste në të cilat bëhet i pamundur kontrolli i Inspektoratit mbi nxjerjen e rërës, zhavorit dhe gurit. Kjo tregon se gjatë implementimit të politikës të regullimit të trupave ujore sipërfaqësore, egzistojnë praktika joligjore.

Mangësitë e sistemit që mundësojnë manipulim dhe nxjerje të pakontrolluar të rërës, zhavorit dhe gurit

Organet kompetente që kanë rol kryesor për zbatimin e politikës të regullimit të trupave ujore sipërfaqësore janë Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor(Sektori për ujëra në Drejtorinë për mjedis jetësor dhe Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor). Njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë kompetencë për regullimin dhe mirëmbajtjen e ujërave në regjionet urbane. Gjithashtu, kompetenca të rendësishme ligjore i janë deleguar dhe SHA Ekonomia e ujërave, për regullim të trupave ujore sipërfaqësore në rajonin e veprimit.

Për nxjerjen e rërës, zhavorit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e rrjedhave lumore, Ministria jep licencë. Me licencë përcaktohet lokacioni, sasia, mënyra, koha, pajisjet dhe mjetet për nxjerje, ngarkim dhe transport të rërës, zhavorit dhe gurit, dhe kjo duhet të evidentohet në librin ujor(sistemin informativ). Licenca mund të jepet vetëm në pajtim me dokumentin planor- Plani për menaxhim me rrjedhë ujore. Ai përmban program për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm mbi ujërat në të cilën parashihet regullim i rjedhave ujore si masë preventive nga ndikimi i dëmshëm, si dhe plan operativ për mbrojtje nga vërshimet. SHA Ekonomia e ujërave, nuk ka sjellë program operativ për rajonin ku vepron, dhe vetëm numër i vogël i komunave kanë miratuar kështu plan operativ. Kështu dokumente nuk janë sjellur nga asnjë nga katër rajonet të rrjedhave lumore në teritorin e shtetit.

Tjetër, me rëndësi për dhënien e licencave për nxjerje të rërës, zhavorit dhe gurit, është plotësimi i detyrimeve ligjore të Ministrisë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor dhe Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujërave, për komunat dhe për SHA Ekonomia e ujërave për përcaktim të kufijve të rajoneve erodive dhe të rajoneve të rrezikuara nga erozioni, si dhe masat për mbrojtje nga erozioni. Akte me të cilat përmbushet ky detyrim ligjor nuk ka.

Regullimi dhe mirëmbajtja e ujërave sipërfaqësore me nxjerje të rërës, zhavorit dhe gurit është e logjikshme vetëm atëherë nëse subjekti që është përgjegjës për regullim, para asaj në pajtim me ligjin ka miratuar program për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm mbi ujërat, plan operativ për mbrojtje dhe mbrojtje nga vërshimet. Me këto dokumente, subjekti që është përgjegjës për regullim të ujërave sipërfaqësore duhet ti përcakton rajonet erodive, rajonet që janë të rrezikuara nga erozioni dhe kufijtë e tyre. Gjithashtu, nxjerja e rërës, zhavorit dhe gurit duhet të jetë e regulluar si masë për mbrojtje nga ndikimi



i dëmshëm, erozioni dhe regullim të ujit nga reshjet në programin dhe planin operativ. Këto detyrime ligjore nuk janë të përmbushura, dhe për atë arsye dhënia e licencave nuk është në pajtim me ligjin dhe sjell deri ne konkluzion se baza për përcaktimin e lokacioneve ku duhet të nxjeret rërë, zhavor dhe gur nga ujërat sipërfaqësore nuk është planor dhe nuk është i paraparë për qëllimet e regullimit dhe mirëmbajtjes të shtretërve të lumejve.

Në procedurat për sigurim të licencave, është e obligueshme të dorëzohet dokumentacion teknik(proekt themelor, revizion të proektit dhe elaborat gjeodezik), të cilin për kërkuesin e licencës e pregadit subjekt juridik i regjistruar për atë veprimtari. Në regulloret nuk egziston kufizim kohor për vlerën e dokumentacionit teknik, dhe për atë lihet mundësi dokumentacioni që dorëzohet mos të korespondon me gjendjen faktike në teren.

Mungesa e gjitha dokumenteve të lartëpërmendura e problematizon egzistimin e arsyeve dhe kritereve gjatë zgjedhjes të lokacioneve për nxjerjen e rërës, zhavorit dhe gurit, dhe për shkak të kësaj, baza sipas të cilës jepen licencat të deritanishme, si dhe ajo a ka dhënia e tyre për qëllim përmirsimin e regjimit të ujërave dhe mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm ose bëhet fjalë për nxjerje të materijalit për qëllime komercijale. Në rajonin e rrjedhës të lumit Vardar, i cili përfshin më tepër se 80% nga resurset e përgjithsme ujore në teritorin e Republikës të Maqedonisë të Veriut, në periudhën deri vitin 2017 janë dhënë 66 licenca/pëlqime të ekonomisë të ujit.

Realizim i profitit nëpërmjet shitjes të rërës,zhavorit dhe gurit në kundërshtim me interesin publik

Sipas Ligjit për ujëra, nëse me licencë është përcaktuar një pjesë e materijalit të largohet nga shtrati dhe brigjet, bartësi i licencës mund ta lishon në qarkullim me dokument të nxjerur dhe të vërtetuar nga organi administrativ kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor. Në praktikë është evidente mungesa e këtyre dokumenteve të nxjerura dhe të vërtetuara nga ana e Ministrisë, dhe shpesh manipulohet edhe në lidhje me sasinë e materijalit që nxjeret.

Për kushtet, mënyrën dhe procedurën e shitjes të materialit të nxjerur nuk ka dispozita në Ligj, as nuk ka kufizime, dhe për atë arsye ato përcaktohen nga bartësi i licencës. Te SHA Ekonomia e ujërave, nëpërmjet procedurës për ankand publik zgjedhet ai ofrues/blerës i cili materijalin e nxerur mund ta mer nga depot, por dhe ta nxjer me mekanizim personal. Në praktikë, egzistojnë raste kur ofruesi nuk posedon me mekanizim të vet, dhe ky lidh marrëveshje me persona tjerë për shfrytëzim të mekanizimeve të tyre dhe shitje të materijalit me çmim më të lartë nga ajo e cila i ofrohet nga SHA Ekonomia e ujërave, dhe realizon të ardhura më të larta nga ato të bartësit të licencës, që paraqet dhe motiv për nxjerjen e rërës, zhavorit dhe gurit.

Në mungesë të mekanizmave dhe kritereve kontrolluese, këto dispozita dhe praktika sjellin deri te legalizimi sistematik i nxjerjes të rërës,zhavorit dhe gurit nga trupa ujore sipërfaqësore për qëllime komercijale dhe eksploatim të tyre si lëndë e parë minerale. Nga kontrollet në teren për nevojat për pregaditjen e raportit të Entit shtetëror për revizion të vitit 2019, është vërtetuar se me përjashtim të licencave/pëlqimeve kur bartës është komuna, në çdo rast tjetër, gjatë nxjerjes të materijalit nga shtrati dhe brigjet e lumejve, akcenti kryesor vihet në shitjen

e tij, në vend të regullimit dhe mirëmbajtjes të lumejve. Marrëveshje të caktuara për nxjerje të rërës, zhavorit dhe gurit arrijnë vlerë rreth 50 mijë euro, dhe në dispozitat nga marrëveshjet e nënshkruara me subjekte ligjore nuk janë të përfshira dispozita për mënyrën dhe aktivitetet që duhet të ndërmeren për regullimin ose përmirsimin e regjimit të ujërave, por vetëm për sasinë e materijalit që nxjeret dhe shitet, pa marë parasysh a bëhet fjalë për tepricë sipas licencës nga Ministria. Rërë, zhavor dhe gur nxjeret deri sa të arihet sasia e paraparë që duhet të nxjeret sipas licencës, pa marë parasysh se ndërkohë është aritur qëllimi për regullim. Askush në teren nuk kryen kontrollë si kryhet "regullimi" i shtretërve dhe brigjeve. Pjesa më e madhe e materijalit të nxjerur përdoret për shitje, kurse pjesa minimale për regullimin e shtratit lumor. Raporti i revizionit shpreh dyshim se dokumentacioni teknik pregaditet nga person i cili më vonë në procedurën e ankandit publik dorëzon ofertë më shpesh si ofrues i vetëm, i cili më vonë edhe e fiton punën edhe është i njohur më parë në transakcion.

Buxheti indikativ që duhet të sjellë deri në efektivitet të politikës për regullim dhe mirëmbajtje të shtratit dhe brigjeve të trupave ujore sipërfaqësore dhe deri te tejkalimi i gjendjes, vlerësohet të jetë 442.300euro, të parapara për krijimin e kushteve themelore për planifikim preciz të nevojës për regullim të shtratit dhe brigjeve të trupave ujore sipërfaqësore, caktim i subjekteve të cilat munden të bëjnë regullim, vendosje e evidencës dhe regullimit të mënyrës të shitjes të tepricës të materijalit të nxjerur, si dhe sigurim i konkurencës dhe transparencës të procesit.

Burime të konsultuara

- Puleska B., Popovski N. (2020). Probleme me menaxhimin me resurset ujore: Si ta shfrytëzojmë dhe ta mbrojmë ujin. Instituti për studime komunikative, Shkup.
- Ligji për ujërat(„Gazeta zyrtare e RM" nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180/14, 124/15, 146/15, 52/16);
- Enti shtetëror për revizion (2019). Raport final për revizion të kryer të suksesshmërisë „Efektivitet nga politikat masat dhe aktivitetet gjatë eksploatimit të rërës,zhavorit dhe gurit nga rrjedha lumore e Vardarit". ESHR, Shkup.



Më tepër në temën të kësaj rezyme është shpjeguar në dokumentin për politikë publike

„Problemet Në Menaxhimin Me Resurset Ujore: Si Ta Shfrytëzojmë Dhe Ta Mbrojmë Ujin".

Институт за комуникациски студии
02 30 90 004 info@iks.edu.mk www.iks.edu.mk

British Embassy Skopje
UKaid from the British people

Ky produkt është pregaditur në suaza të proektit "Bashko pikat: Politika të përmirsuara nëpërmjet pjesëmarjes qytetare", i financuar nga Qeveria e Mbretërisë të Bashkuar, me përkrahje të ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet të përmendura në këtë përmbajtje nuk i reflektojnë çdoherë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë britaneze.